

Përmbledhje

PROKURORJA E PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, ARMIDA HAMITI, PËRBALLET ME PROCESIN E RIVLERËSIMIT PRANË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 19/12/2022 PRANË KPK:**

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret e rivlerësimit, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit.

KPK në hetimin administrativ ka konstatuar deklarime të pasakta si mospërputhja e sipërfaqjes së apartamentit të deklaruar dhe mungesë në krijimin e pasurisë së ligjshme, duke ngritur dyshime mbi kontributin e subjektit si pjesëtare e familjes bujqësore, të ardhura të përdorura në blerjen e një apartamenti.

**Komisioni në seancën e datës 21.12.2022,
konfirmoi në detyrë prokuroren.**



Trupa gjykuese e KPK ngre pyetje mbi kontributin e subjektit të rivlerësimit znj. Armida Hamiti, prokurore e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si pjesëtare e familjes bujqësore

Më datë 19.12.2022 ora 10:00, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Armida Hamiti (Moçka), prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupa gjykuese përbëhej nga z. Roland Ilia (Kryesuese), znj. Brunilda Bekteshi (Relatore) dhe znj. Pamela Qirko (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt se subjekti nuk kishte zgjedhur të përfaqësohej nga ana e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej saj, nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin administrativ ose konflikte të mundshme interesi me trupën gjykuese. Relatimi për kriterin e pasurisë, në raport kohor me dy kriteret e tjera atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, zuri pjesën më të madhe të seancës dëgjimore.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Ndryshe nga këto raporte, Komisioni në hetimin administrativ ka konstatuar deklarime të pasakta si mospërputhja e sipërfaqjes së apartamentit të deklaruar dhe mungesë në krijimin e pasurisë së ligjshme, duke ngritur dyshime mbi kontributin e subjektit si pjesëtare e familjes bujqësore, të ardhura të përdorura në blerjen e një apartamenti. Gjatë seancës dëgjimore, trupa gjykuese i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 52 të ligjit 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u përgjigj pyetjeve të adresuara nga ana e trupës gjykuese, duke argumentuar se të ardhurat për blerjen e apartamentit rrjedhin nga bashkëpronësia mbi tokën ku familja bujqësore kryen aktivitetin e saj fitimprurës.

Pranë Komisionit, ishte depozituar vetëm një denoncim nga ana e një qytetari. Përkundrejt nevojës për transparencë dhe publicitetit të çështjes në seancë, nga ana e relatores së çështjes nuk u bë e ditur natyra apo objekti i denoncimit.

Në përfundim të seancës Komisioni caktoi datën 21.12.2022, ora 9:45, për shpalljen e vendimit përfundimtar ku prokurorja u konfirmua në detyrë.